

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË "ALB - EXCHANGE"**  
**Sh.p.k**

Sot, me datë 21 / 06 / 2021,

1. **Z. Klajdi Bektashi**, i biri i Ylli, lindur më 27 / 07 / 1989 në Tiranë, banues në Tiranë, Rruga Todi Shkurti ,pallati Grand , ,mbajtes I kartes se identitetit (ID) me Nr. 034074355 dhe Nr.Personal I90727073Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar ;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**ALB - EXCHANGE**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**ALB - EXCHANGE**" Sh.p.k

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: TIRANË, Njesia Administrative Nr. 5, Rruga "Gjok Kuqali ", Pallati Nr. 7/1, Apartamenti Nr. 1, Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**


Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Veprimtaria financiare e këmbimeve valutore, shitje/blerje valute, shitje/blerje çeqe udhëtarësh, transferimi i parave, shërbime financiare, roli i agentit në ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të perafert me të vetin.

Gjithashtu, brenda kufijve të percaktuar nga ligji mund të leshojë garanci, letra demshperblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.



## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2.500.000 (dy milion e peseqindmijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Klajdi Bektashi**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e peseqindmijë) Lekë dhe 2.500.000 (dy milion e peseqindmijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Klajdi Bektashi** shtetas shqiptar, lindur më 27/07/1989, në Tiranë, mbajtës i dokumentit Pasaportë me nr. BI3403225, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin, Z. Klajdi Bektashi**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**Klajdi Bektashi**